




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 21.08.2020, parashtruar nga subjekti: " Hysen Sopa B.I. "emrri i biznesit / N.N.SH. " Emsa " me seli në Suharekë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 31.08.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e Eliminuar të subjektit në procedurë: " Hysen Sopa B.I. "emrri i biznesit / N.N.SH. " Emsa " me seli në Suharekë
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 21.08.2020

A r s y e t i m

Organi Shqyrtues i Prokurimit,(më tej OSHP), në Vendimin e tij nr. 399/20 dt. 27.07.2020 në mes tjerash ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin për Dhënie të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i kiosqeve në Sheshin " Adem Jashari " në Vushtrri me nr. prok. 644-19-771-5-2-1 Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 010 – 521, ndërsa lënda është kthyer në rivlerësim.

Në zbatim të Vendimit të OSHP-së, bazuar dhe në nenin 72 të LPP-së, A.K. , nga O.E. : " Mazreku " sh.p.k. & " AAB Construction "sh.p.k. , nga O.E. " Kopshti "sh.p.k., nga O.E. " Hysen Sopa B.I. "emrri i biznesit / N.N.SH. " Emsa " si dhe nga O.E. : N.N.P. "Wenda " ka kërkuar sqarime respektivisht dëshmi shtesë lidhur me aktivitetet punuese të ngjashme të përfunduara në tre vitet e fundit, bazuar në Listën e projekteve të cilën O.E. në fjalë e kanë dorëzuar bashkangjitur me Dosjen e Tenderit.

Më tej Autoriteti Kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K.) nga procesi i rivlerësimit mbi bazën dhe të dëshmimeve të dorëzuara nga O.E. të cituar si më lartë , padiskutueshëm ka konstatuar se tre nga katër O.E nga të cilët është kërkuar sqarim tenderi, O.E. : " Mazreku " sh.p.k. & " AAB Construction "sh.p.k. , O.E. " Kopshti "sh.p.k., dhe O.E. " Hysen Sopa B.I. "emrri i biznesit / N.N.SH. " Emsa " me dëshmi konkrete, Paramasë Paralogari të punëve të përfunduara të projekteve nga Lista e Projekteve të përfunduara në tre vitet e fundit, kanë dëshmuar se kanë përfunduar së paku një projekt të ngjashëm me titullin e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi i parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim " Hysen Sopa B.I. "emrri i biznesit / N.N.SH. " Emsa " me seli në Suharekë , në tekstin e mëtejme Ankuesi se A.K. , duke vendosur si në Vendimin e dt. 21.08.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1-Qëllimi, nenin, nenin 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7–Barazia dhe Trajtimi, nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve dhe nenin 60 – Kriteret për Dhënie të Kontratës, sikurse ka konstatuar A.K. janë plotësisht të pasakta, të paargumentuara dhe juridikisht të paqëndrueshme, sepse A.K. ka respektuar dhe zbatuar drejt rekomandimet e OSHP-së të dhëna në Vendimin e tij nr. 399/20 dt. 27.07.2020 kur ka kërkuar nga O.E. sqarime shtesë. Veprimet procedurale të A.K. kanë qenë konform nenit 72 të LPP-së lidhur me Kërkesa për

sqarim tenderi sepse informata sqaruese janë kërkuar vetëm për projektet të cilat janë pasqyruar në Listën e projekteve të cilat janë dorëzuar nga O.E.. Kjo, padiskutueshëm , nuk paraqet plotësim material dhe as shkelje e dispozitave të nenit 59 të LPP-së lidhur me Ekzaminimin, Krahasimin dhe Vlerësimin e tenderëve të O.E.

Po ashtu pretendimi i Ankuesit lidhur me “ Res Judicata “ sikurse ka konstatuar A.K. është plotësisht i pasaktë sepse A.K. ka vlerësuar se pikërisht rekomandimi i OSHP-së për A.K. , që A.K. të kërkoj sqarime se a vërtet O.E., në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratës , kanë përfunduar punë të ngjashme me titullin e aktivitetit të prokurimit , respektivisht se kontratat dhe dëshmitë tjera shtesë të O.E. a janë konformë kërkesave të tenderit, nënkupton se çështja ende nuk ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm nga A.K. prandaj dhe veprimet procedurale të A.K. kanë qenë të drejtuara pikërisht në atë çfarë ka rekomanduar OSHP, prandaj dhe veprimet procedurale të A.K. janë plotësisht në harmoni me vendimin e OSHP-së, nenin 72 dhe 59 të LPP-së.

Në fund A.K. vlerëson se Vendimi për ta refuzuar si të pabazuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga Ankuesi është marrë bazuar në rezultatet e konstatuara nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, mbi bazën e dispozitave të nenit 59 të LPP-së lidhur me nenin 39.8 të RRUOPP. Më tej A.K. vlerëson se, bazuar në procedurën e zbatuar dhe në argumentimin si në shkresat e lëndës, me asnjë element nuk mundë të vërtetohet se A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së dhe / ose Rregullat RUOPP.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, parashtruesi i Kërkesës për rishqyrtim mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 010/2020 - datë 31/08/2020

Aktvendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik


Hyda Dallku - ZPP